

TERRORISM AS A RISK FOR THE SECURITY OF KOSOVO

Besim Kelmendi

College Biznesi, Prishtina, Kosovo, besim.kelmendi@hotmail.com

Abstract: From the moment of the appearance of terrorist organizations in Arab countries, Kosovo became part of various secret services, which influenced a small number of young people from Kosovo to join these organizations. To prevent such an approach of young people, Kosovo has taken very serious steps in completing the legal infrastructure and in the field of investigations, arrests and sentencing of those who were or attempted to become part of these terrorist organizations.

This paper will address the causes and elements of terrorism in general and in Kosovo in particular, the mission and objectives of Kosovo for the prevention and fight against terrorism, the analysis of this phenomenon in the legal-criminal aspect and its consequences in internal security and outside Kosovo.

Keywords: terrorism, crime, elements, prevention, combat

TERRORIZMI SI RREZIK PËR SIGURINË E KOSOVËS

Besim Kelmendi

Kolegji “Biznesi” Prishtinë – Kosovë, besim.kelmendi@hotmail.com

Abstrakt: Që nga momenti i paraqitjes së organizatave terroriste në vendet arabe, Kosova u bë pjesë e shërbimeve të ndryshme sekrete, të cilat ndikuan që një numër i vogël i të rinjve nga Kosova ti bashkohen këtyre organizatave. Për të parandaluar një qasje të tillë të të rinjve, Kosova ka bërë hapa shumë serioz në plotësimin e infrastrukturës ligjore dhe në fushën e hetimeve, arrestimeve dhe dënimit të atyre që ishin ose tentuan që të bëhen pjesë e këtyre organizatave terroriste.

Ky punim do të trajtoj shkaqet dhe elementet e terrorizmit në përgjithësi dhe në Kosovë në veçanti, misionin dhe objektivat e Kosovës për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, analizën e këtij fenomeni në aspektin juridiko-penal si dhe pasojat e tij në sigurinë e brendshme dhe të jashtme të Kosovës.

Fjalët kyçe: terrorizëm, krim, elemente, parandalim, luftim

1. HYRJE

Për çdo vend, pavarësisht historisë së shtetformimit, forcës ushtarake dhe policore, numrit të banorëve, si dhe pozitës gjeostrategjike, terrorizmi dhe krimi i organizuar mund të jenë ndër shkaktarët më të fuqishëm të rrezikut dhe destabilizimit.

Sot në botë dhe në veçanti në vendet arabe dhe në vendet euroatlantike po mbisundon frika nga sulmet e mundshme terroriste nga grupet e ndryshme islamiste, të cilat kinse në emër të islamit po ndërmarrin akte për çlirimin e botës islame nga të gjithë të tjerët që nuk përputhen me idetë e tyre.

Gjithashtu shumica e vendeve në botë janë duke marr masa, qoftë brenda vetë sistemeve mbrojtëse të tyre qoftë në bashkëpunim me vendet tjera, për të parandaluar dhe luftuar terrorizmin, si njërin ndër krimet më të shëmtuar të ditëve të sotme.

Aktet terroriste nuk janë të drejtuara vetëm kundër një vendi të caktuar, por kundër çdo vendi që është kundër ose nuk mbështet organizatat terroriste. Në mesin e vendeve që janë përballur me dukurinë e terrorizmit sot është edhe Kosova, e cila në dallim prej disa vendeve tjera ka arritur mjaft suksese në parandalimin e shtetasve të saj që ti bashkëngjiten organizatave terroriste në vendet arabe. Ky konstatim mund të nxjerrët duke marr për bazë krahasimin e numrit të shtetasve të Kosovës që në fillim të luftës në Siri i ishin bashkëngjitur organizatave terroriste dhe numrit të sotëm të këtyre qytetarëve, që sipas të dhënave të fundit të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, si dhe Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës në këtë vit nuk ka informata për shkuarjen e ndonjë qytetari të Kosovës në Siri apo Irak ose në ndonjë vend tjetër për të ju bashkëngjitur organizatave terroriste.

1.1. Kuptimi i terrorizmit

Lidhur me kuptimin e terrorizmit sot në botë ka qëndrime të ndryshme, varësisht nga kush e bënë përkufizimin e terrorizmit dhe nga cili këndvështrim shikohen veprimet ose aktet terroriste dhe nga vet llojet e terrorizmit. Kjo ndodh për shkak së një pjesë e atyre që kryejnë veprime ose akte terroriste, këto veprime i konsiderojnë si veprime për liri apo për çlirimin e vendeve të tyre ose për të arritur në pushtet, ndërsa në anën tjetër ata që merren me parandalimin dhe luftimin e këtyre veprimeve apo kateve terroriste dallojnë varësisht së nga cili këndvështrim

politik i shikojnë këto akte. Kështu një akt terrorist do të trajtoj ndrysh Rusia e ndrysh Shtetet e Bashkuara të Amerikës, varësisht së si atyre u preken interesat shtetërore.

Kodi penal i Republikës së Kosovës (tash e tutje KPRK) ka përkufizuar si terrorizëm, veprim terrorist apo vepër e terrorizmit - kryerjen e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare: vrasja apo vrasja e rëndë, shtytja apo ndihma në vetëvrasje, sulmi, sulmi me lëndim të lehtë trupor dhe sulmi me lëndim të rëndë trupor, marrja e pengjeve, rrëmbimi ose privimi i kundërligjshëm nga liria, ndotja e ujit të pijshëm ose e produkteve ushqimore; ndotja ose shkatërrimi i mjedisit, shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm; zjarrvënja apo djegia ose shpërthimi nga pakujdesia, shkatërrimi, dëmtimi ose heqja e instalimeve publike apo rrezikimi i trafikut publik, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi ose shitja e paautorizuar e armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike, përvetësimi i paautorizuar, mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose përdorimi i armëve, eksplozivit ose armëve nukleare, biologjike ose kimike, ose hulumentet për ose ndërtimi i armëve biologjike ose kimike, rrezikimi i personave të mbrojtur ndërkombëtarisht, rrezikimi i personelit të Kombeve të Bashkuara dhe i personelit në marrëdhënie me to, rrëmbimi i fluturakes ose marrja e kundërligjshme e fluturakes, ose rrëmbimi i mjeteve tjera të transportit publik apo të transportit të mallrave, rrezikimi i sigurisë së aviacionit civil, rrëmbimi i anijeve ose rrezikimi i sigurisë së lundrimit detar, rrezikimi i sigurisë së platformave fikse të vendosura në pragun kontinental, përvetësimi, përdorimi, transferimi ose deponimi i paautorizuar i materialeve nukleare, kanosja për përdorimin apo vjedhjen ose grabitjen e materialeve nukleare ose kanosja për kryerjen e ndonjëris prej veprave të saktësuara më sipër⁷⁰.

Një përkufizim i tillë në KPRK, është bazuar edhe në konventën e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të Terrorizmit, sipas të cilës çdo person konsiderohet se kryen një shkelje nëse ai direkt ose indirekt, në mënyrë të paligjshme dhe me dëshirë, siguron ose grumbullon fonde me synimin që ato të përdoren ose ka dijani se ato do të përdoren plotësisht ose pjesërisht për të kryer: (a) një veprim që përbën një shkelje brenda kuadrit të shkeljeve të përcaktuara në një prej traktateve të listuara tek aneksi; ose (b) çdo akt tjetër që ka për qëllim të shkaktojë vdekjen ose plagosje të rëndë trupore të një civili ose të çdo personi tjetër që nuk merr pjesë aktive në armiqësitë e situatave të një konflikti të armatosur, kur qëllimi i një veprimi të tillë nga natyra ose konteksti është ta frikësojë popullatën ose ta detyrojë qeverinë ose një organizatë ndërkombëtare të kryejë ose të mos e kryejë një veprim⁷¹.

Shikuar historikisht, fjala “terreur”, nënkupton frikë dhe panik. Disa autor deklarojnë së për herë të parë kjo fjalë është përdorur gjatë Revolucionit Borgjez - Francez, në kuptim të dënimeve drakonike të shqiptuara nga gjykatat revolucionare, kundër armiqve të Republikës së Re. Që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme, fjala “terror”, shërben si sinonim i gjendjes shpirtërore të frikës individuale, si pasojë e presionit të caktuar politik, si dhe për shpjegimin e pozicionit kolektiv përballë një rreziku të caktuar (terreur panique)⁷²

Fjala “terror” kuptohet si zbatim i dhunës politike me qëllim të mbrojtjes së interesave shtetërore gjatë fazave të ndryshme revolucionare të karakterizuara me kërcënime dhe zbatime të ndryshme të dhunës politike. Këtu terrori, si dhunë e instrumentalizuar, zakonisht propagandohet në mënyrë të stilizuar, si mjet i domosdoshëm për mënjanimin e konflikteve të ndryshme politike, rivendosjen e rendit, qetësisë publike ose harmonisë shoqërore⁷³

Fjala “terrorizëm” nënkupton veprat e ndryshme penale të drejtuara kundër shtetit, të kryera nga individët ose grupet e ndryshme të personave në shtetin e vet ose në shtetin e huaj, me qëllim të ndikimit në realizimin e qëllimit të caktuar politik⁷⁴

Terrori dhe terrorizmi nuk kanë kuptim të njëjtë dhe nuk janë dukuri identike. Dallimi që ekziston në mes të këtyre dy nocioneve, respektivisht në mes të këtyre dy dukurive, ka të bëjë me faktin se terrori është dhunë shtetërore, e cila zbatohet me qëllim të ruajtjes ose të rivendosjes së pushtetit shtetëror, ndërsa terrorizmi është zbatimi i dhunës politike nga aktorët e ndryshëm jashtë shtetëror me qëllim të ndërrimit ose marrjes së pushtetit⁷⁵

Përkufizimi i “Terrorizmit Ndërkombëtar”, sanksionohet qartë edhe në Kodin e Terrorizmit Ndërkombëtar të SHBA-së (18 U.S.C, 2331), si më poshtë:

⁷⁰ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 2012, neni 135, f. 161-163

⁷¹ Konventën e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të Terrorizmit, 1999, neni 2 f.3

⁷² Handbuch politisch - sozialer Grundbegriffe in Frankreich 1680 - 1820, München 1985, f. 89 – 90, vepër e cituar nga Krasniqi, Kolë, 2010, Terrorizmi Ndërkombëtar f.22

⁷³ Po aty

⁷⁴ Po aty

⁷⁵ Krasniqi, Kolë, 2010, Terrorizmi Ndërkombëtar, f.23

“Terrorizëm Ndërkombëtar, do të thotë aktivitet me tre karakteristika, që përfshijnë veprime të dhunshme ose akte të rrezikshme për jetën e njeriut që shkelin ligjin federal ose shtetëror. Që ka për qëllim : 1.) Frikësimin ose detyrimin e një popullsie civile. 2.) Ndikimin në politikën e një qeverie me anë të frikësimit, detyrimit. 3.) Të diktojë sjelljen e një qeverie me anë të frikësimit, detyrimit, shkatërrimit në masë, vrasjeve dhe rrëmbimeve. Këto akte terroriste ndodhin jashtë juridiksionit territorial të SHBA-së, ato i kapërcejnë kufijtë kombëtar”⁷⁶. Lidhur më fjalën “terrorizëm” disa autor theksojnë se kjo fjalë është fjalë latine “terror” e cila tregon tmerrin, trishtimin shkaktimin e frikës dhe dridhjes dhunës politike e deri të shkatërrimi fizik i kundërshtarit⁷⁷. Sipas Konventës së Gjenevës (1937), që asnjëherë nuk hyri në fuqi, terrorizmi është vepër penale e drejtuar kundër shtetit më qëllim të krijimit të një gjendje të tmerrit, frikës dhe terrorit në vetëdijen e grupeve të caktuara të njerëzve apo qytetarëve⁷⁸.

Për terrorizmit kanë bërë përpjekje edhe disa organizata ose institucione që të bëjnë përkufizimin. Këtu velen të përmendet F.B.I. e cila konsideron se terrorizmi nënkupton përdorim të kundërligjshëm të forcës dhe dhunës kundër personave apo pasurisë së tyre, duke kanosur apo shtërnguar qeverinë, popullatën civile apo ndonjë segment të tyre për mundësimin e arritjes dhe realizimit të qëllimeve të caktuara sociale dhe politike⁷⁹.

Këtu vlen të përmendet edhe përkufizimi i shprehjes “grup terrorist” dhe “grup i strukturuar” sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Kështu shprehja “grup terrorist” nënkupton grupin e strukturuar prej më shumë se dy personave, që ekziston për një periudhë kohore dhe i cili vepron në bashkëpunim për kryerjen e terrorizmit, ndërsa shprehja “grup i strukturuar” nënkupton një grup i cili nuk është formuar rastësisht për kryerjen e menjëhershme të një veprë dhe i cili nuk ka nevojë të ketë role formalisht të përcaktuara për anëtarët e tij, vazhdimësinë e anëtarësisë ose strukturë të ndërtuar⁸⁰.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka dhënë edhe përkufizimet e shprehjeve “Fonde” dhe “burime financiare”. Lidhur më fjalën “fonde” është dhënë sqarimi se më këtë fjalë nënkuptohet pasuria e çfarëdo lloji, qoftë e preکشme ose e paprekshme, e luajtshme ose e paluajtshme, sido që të jetë fituar, dhe dokumentet apo instrumentet ligjore në çfarëdo forme, përfshirë formën elektronike ose digjitale, të dëshmuarit e pronësisë ose të interesit në pasuritë e tilla, përfshirë por pa u kufizuar në, kreditë bankare, çeqet e udhëtarëve, çeqet bankare, urdhërpagesat, aksionet, letrat me vlerë, detyrimet, çeqet dhe letërkreditë, ndërsa shprehja “burime financiare” nënkupton por nuk kufizohet në, dhënie me qira, objektet e trezorëve, dokumentacionin ose identifikimin e rrejshëm, shërbimet financiare, pajisjet, personelin, armët, mjetet e transportit, pajisjet e komunikimeve dhe pasurinë tjetër fizike, përveç medikamenteve të domosdoshme.

Nga ajo që u theksua më sipër rezultojnë se disa autor i interpretojnë aktet e terrorizmit si krim, si proces politik, si luftë, si proces komunikimi dhe/ose si kryqëzatë⁸¹.

Në fund mund të thuhet se “Një problem themelor i kuptimit që ne kemi për terrorizmin është vetë përkufizimi i tij. Mungesa e saktësisë në përdorimin e tij i ka shtyrë disa të besojnë se koncepti nuk mund të ketë një përkufizim konkret brenda një konteksti normativ. Pjesë e problemit është kategorizimi që ne i bëjmë atij si një aktivitet në thelb kriminal. Në fakt terrorizmi është në teknikë. Terrori është një fenomen i natyrshëm; ndërsa terrorizmi është shfrytëzimi i vetëdijshëm i terrorit. Terrorizmi është imponues, i ideuar për të manipuluar vullnetin e viktimave të tij dhe audiencën më të gjerë. Vetë natyra e krimit prodhon një shkallë kaq të lartë frike, nëpërmjet aktit të kryerjes së veprës ose nëpërmjet indiferencës që ky akt tregon për jetën njerëzore. Kjo frikë e tmerrshme përbën burimin e fuqisë së terroristit dhe i komunikon sfidën e tij shoqërisë⁸².”

2. ELEMENTET E TERRORIZMIT

Kur flitet për elementet e terrorizmit, zakonisht merren për bazë përkufizimet ose definicionet literaturës ose autorëve të ndryshëm të terrorizmit. Nga analiza e përkufizimeve rezultojnë se janë dhënë rreth 109 përkufizime të

⁷⁶ Meqalla, Eraldo, marr nga <http://ëëë.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar/>, qasja më datë 20.06.2017

⁷⁷ Demolli, Haki, 2002, Terrorizmi, f.6, vep.e cit. nga Mirko Klarin “Terrorizmi” Beograd, 1979 f.24

⁷⁸ Konveta e Gjenevës mbi pengimin dhe ndëshkimin e terrorizmit, 1937

⁷⁹ Ralph, F.Pearl, etj, “America is not immune to attacks” Targeting terrorism, special Washington file.nr.166, March 1997, f.9, vep. E cit. nga Demolli, Haki në veprën “Terrorizmi” Fakulteti Juridik Prishtinë, 2002, f.8

⁸⁰ Kodi Penal I Republikës së Kosovës, 2012, neni 135 paragrafi 4, f.63

⁸¹ Hide, Enri, Terrorizmi dhe reagimi shtetror pas luftës së ftohtë, Tiranë, marr nga

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/02/Doktoratura-Enri-Hide-Fakulteti-i-Histori-Filologjise-Departamenti-i-Historise.pdf>, f.11, qasja mw datw 26.06.2017

⁸² Po aty, f.13

terrorizmit dhe nga këto përkufizime autorët e ndryshëm kanë ardhur deri të identifikimisë paku 22 elementeve të terrorizmit⁸³, ndër të cilat më ketë rast do të përmenden vetëm disa prej tyre.

Përdorimi i dhunës dhe forcës, karakteri politik, shkaktimi i frikës dhe tmerrit, kanosja, efektet dhe reaksionet psikike, zgjedhja e viktimave dhe dhe caqeve të caktuara të sulmit, veprimi sistematik i organizuar, i planifikuar dhe i qëllimshëm, metoda, strategjia dhe taktika e luftës apo sulmeve, “Ekstranormaliteti”, shkelja e rregullave të pranuar dhe mungesa e arsyeve humanitare, shantazhi, detyrimi në dëgjueshmëri, dëshira për publicitet të akteve terroriste, rrezikimi – asgjësimi i njerëzve ose grupeve të njerëzve dhe pasurisë në përmasa të mëdha, nxjerrja e koncesioneve politike dhe fitimi i pushtetit.

Nëse shikohen këto elemente veç e veç rezulton së nuk ka terrorizëm nëse nuk ka dhunë, e cila sot ushtrohet më anë të mjeteve të ndryshme, duke përfshirë të gjitha llojet e mundshme të armëve të zjarra (siç armët më predhë dhe eksplozivet e ndryshme), armëve kimike dhe armëve të ftohta (siç është rasti i përdorimit të thikave apo shpatave të ndryshme për heqjen e kokave të pengjeve ose personave tjerë të rrëmbyer nga grupet terroriste)

Jo rrallë në vendet e ndryshme të botës ka patur raste kur partitë ose grupet politike janë shndërruar në grupe terroriste, të cilët i proklamojnë veprimet e tyre si veprime patriotike për realizimin e ideve të tyre ose çlirimin e vendit ose territoreve të tyre. Këtu mund të përmenden organizatat e njohura siq janë: IRA në Irlandë, ETA në Spanjë, PLO në Palestinë, FLQ në Kvebek, FLNC në Korsikë etj. Përveç këtyre organizatave këtu vlen të përmendet në veçanti organizatat që për bazë kanë bindjet e tyre religjioze siq janë AlKaida, Al Nustra dhe ne veçanti ISIS e cila në kohën e fundit është organizatat më e njohur terroriste në botë dhe e cila është duke kryer aktet më të tmerrshme terroriste, jo vetëm në Siri dhe Iraku, ku është e përqendruar por edhe në shumë vende të botës.

Organizatat terroriste që kanë për bazë ideologjinë religjioze, rezultojnë që të jenë më të rrezikshme se sa organizatat e krijuara më qëllime nacionaliste, sepse ideologjia religjioze përfshinë një numër shumë më të madh të anëtarëve dhe simpatizantëve të këtyre organizatave dhe atom und të shpërndahen më lehtësi në tërë vendet e botës ku popullatë të një religjioni të cilës i përket organizata. Jo rrallë këto organizata terroriste me ideologji religjioze kanë në programet e tyre zhdukjen apo shfarosjen e religjioneve tjera dhe kjo tregon se sat ë rrezikshëm janë në veprimet e tyre.

Duke marr për bazë aktet terroriste të kryera në vitet e fundit nga organizatat terroriste ISIS jo vetëm në Siri dhe Irak, por edhe në vendet e ndryshme të botës e në veçanti në Europë, rezultojnë që këto akte kanë krijuar një frikë dhe ndjenjë të pa sigurisë tek të gjithë njerëzit pavarësisht përkatësisë së tyre etnike dhe religjioze, sepse asnjë njeri kush do qoftë ai nuk e ka ndjenjën e sigurisë nëse gjendet në një vend ku ka shumë njerëz siq janë aeroportet, stacione e trenave apo autobusëve, qendrat tregtare, shëtitoret, manifestimet kulturore, ditët e festive shtetërore apo religjioze etj. Kjo mënyrë e kryerjes së këtyre akteve terroriste ka për qëllim që përmes krijimit të tmerrit dhe frikës në popullatë të shtyn udhëheqësit politik të këtyre vendeve që të pranojnë këto organizata si partner në bisedime dhe për të ju plotësuar kërkesat e tyre ideore.

Të gjitha organizatat terroriste, përmes akteve terroriste kanë një qëllim, që të arrijnë qëllimet e tyre politike, religjioze dhe në fund të fundit ekonomike, sepse dëshirojnë që të bëjnë presion në të gjitha vendet ku i kryejnë këto akte por edhe në vendin ku dëshirojnë të marrin pushtetin, për të përfutuar në aspektin politik, ushtarak, religjioz dhe ekonomik.

Të gjitha këto veprime apo akte terroriste zakonisht arrihen përmes financimit, rekrutimit, trajnimit, logjistikës, planifikimi, transporti, propagandës dhe publikimeve të ndryshme. Terrorizmi arrin në shtëpitë tona nëpërmjet ekraneve televizive, duke na bombarduar nga gazetatat, revistat, ndonjëherë hynë në jetën tona edhe në mënyra të drejtpërdrejta⁸⁴

3. SHKAQET DHE PASOJAT E TERRORIZMIT

Duke marrë parasysh atë që u theksua më sipër rezultojnë së terrorizmi mund të jetë, nacionalist, religjioz, shtetëror, majtist, djathtist dhe anarhist, ndërsa shkaqet e terrorizmit mund të jenë të ndryshme, mirëpo në ketë rast do të përmenden vetëm disa nga këto shkaqe dhe atë:

Konfliktet ndërmjet grupeve të caktuara shoqërore mbi baza etnike, mbi baza ideologjike, mbi baza religjioze, mbi baza raciale dhe shkaqet tjera të terrorizmit

Lidhur më konfliktet ndërmjet grupeve të caktuara shoqërore mbi baza etnike⁸⁵, duhet theksuar së ky shkak i terrorizmit ka bazën në dy segmente:

⁸³ Demolli, Haki, 2002, Terrorizmi, Fakulteti Juridik Prishtinë, f.8

⁸⁴ Latifi, Vesel, Mediat dhe terrorizmi, marr nga http://www.kolegji-juridica.org/new_web/wp-content/uploads/2017/03/Dr.-Vesel-LATIFI-Mediat-dhe-terrorizmi.pdf, f.9, qasja më datë 26.06.2017

⁸⁵ Demolli, Haki, 2002, Terrorizmi, Fakulteti Juridik Prishtinë, f.105-116

a. Në veprimet e regjimit qendror kundër grupeve etnike që kanë për synim: qëllimin e diskriminimit, represionin shtetëror dhe spastrimet etnike dhe

b. Reagimet e pjesëtarëve të grupeve etnike ndaj diskriminimit të shtetit në të cilin jetojnë, siç janë: lufta e hapur apo guerile, krijimi i lëvizjeve separatist, veprimi përmes grupeve të organizuara dhe krijimi i organizatave që kryejnë akte terroriste.

Lidhur më konfliktet ndërmjet grupeve të caktuara shoqërore mbi baza ideologjike janë dy grupe⁸⁶ dhe atë:

Grupet ideologjike majtiste, ku hyjnë idhtaret e komunizmit (grupet: marksiste, leniniste, maoiste) dhe grupet ideologjike djathtiste (reaktionare), ku hyjnë: mbrojtja e tradicionalizmit, dominimi i grupit të caktuar etnik apo racial, lirimi nga ndikimi komunist apo majtist dhe dominimi mbi vlera religjioze. Të gjitha këto karakterizohen me faktin së: gëzojnë përkrahje nga qeveria, kanë pozita në pushtet dhe bashkëpunojnë me shërbime sekrete

Sa i përket konflikteve ndërmjet grupeve të caktuara shoqërore mbi baza religjioze, profesor Haki Demolli këto shkaqe i ndan në dy lloje të konflikteve dhe atë:

Konfliktet në mes grupeve të ndryshme fetare, ku hyjnë: grupet apo sektet fetare dhe konflikti në mes grupeve fetare dhe pushtetit sekularist, ku hyjnë: grupet e ndryshme fetare kryesisht të përkatësisë islame kundër regjimeve në shtetet e tyre dhe rastet kur pushteti e ndalon kultivimin e fesë apo deklarimin fetar.

Edhe të shkaqet e terrorizmit që kanë për bazë konfliktet ndërmjet grupeve të caktuara shoqërore mbi baza raciale, sipas autorëve të ndryshëm⁸⁷ mund të merren për bazë: konfliktet në mes grupeve që u takojnë racave të ndryshme, ku përfshihen: bindja e grupit së janë më të mirë, më të pastër, më të mëncur, më të aftë, më lëkurë të më të mirë etj dhe bashkëpunimi me partitë politike të krahut të djathtë, si dhe konflikti në mes grupeve racore dhe pushtetit, ku përfshihen: sulmet kundër pushtetit në rastin e pranimit të azilkërkuarëve, migrantët dhe refugjatët

Si shkaqe tjera por që nuk kufizohen vetëm më to, janë edhe: frikësimi, heshtja dhe eliminimi i disidentëve politik që veprojnë jashtë vendit, modifikimi politik apo i aksioneve të shteteve tjera (kur e mbështesin pushtetin ku gjenden grupet terroriste apo interesat e tyre, hakmarrja kundër shtetit apo grupeve tjera dhe frustrimi si shkak subjektiv i terrorizmit (kur konsiderohet se u është shkëlur ndonjë e drejtë apo interes)

4. SHKAQET DHE PASOJAT E TERRORIZMIT NË KOSOVË

Edhe pse Kosova është një shtet i ri dhe ende në fazën e konstituimit të institucioneve shtetërore (për shkak të administrimit ndërkombëtar të UNMIK-u dhe mbikëqyrjes së EULEX-it), sa i përket terrorizmit, Kosova nuk ka ndonjë dallim të madh kur bëhet fjalë për shkaqet e terrorizmit. Mirëpo këtu duhet theksuar së edhe pse në Kosovë nuk ka patur ndonjë akt terrorist më përmasa të mëdha si në Siri, Irak, vendet e BE-së, apo vendet tjera të botës, ka patur persona që si individ u janë bashkangjitur organizatave terroriste, që kanë vepruar në Siri dhe Irak.

Lidhur më shkuarjen e personave nga Kosova në Siri apo Irak, duhet theksuar së fillimisht pas zhvillimeve të viteve të fundit në vendet arabe, një ndikim kishte edhe vet qasja e Institucioneve të Kosovës, të cilat më qëllim mbështetjen e ideologjisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për të mbështetur popullin e Sirisë, për ndryshim të pushtetit dhe demokratizimin e vendit, nuk kishin dalur kundër shkuarjes së qytetarëve të Kosovës në Siri edhe pse nga qarqe ose persona të ndryshëm, kryesisht imam të Kosovës, bëheshin thirrje së duhet të shkohet për të ndihmuar opozitën në Siri për rrëzimin e pushtetit të Asadit. Mirëpo këto thirrje më vonë u pa së nuk kishin vetëm qëllimin e ndihmës së opozitës Siriane por për të mbështetur një “luftë të shëjt” që sipas tyre po zhvillohej nga grupe të caktuara, të cilat, nga shumica e vendeve të botës u konsideruar si organizata terroriste.

Lidhur më Kosovën, përveç rasteve që lidhen më terrorizmin, që si bazë ka pikëpamjet religjioze si Al Nuusra dhe ISIS, duhet veçuar edhe atë së ndikimi i ideologjive ekstremiste që bazohen në jo-tolerancë, urrejtje dhe dhunë, për arritjen e qëllimeve politike dhe ideologjike duke keqpërdorur fenë dhe nacionalizmin janë evidente dhe deri diku mjaft të rrezikshme.

Marrëdhëniet ndëretnike vazhdojnë të mbeten të tensionuara, veçanërisht në veri të vendit, ku vazhdojnë të jenë prezent dhe aktive, grupe ekstremiste, të cilat janë të predispozura të përdorin dhunën për arritjen e qëllimeve politike.

Prezenca e madhe në Kosovë e ndërkombëtarëve që vijnë nga shtetet mike të Kosovës, për shkak të angazhimit të tyre në luftën globale kundër terrorizmit, gjithashtu mund të jetë një ndër shkaqet e paraqitjes së akteve terroriste.

Sa i përket pasojave të terrorizmit, nga sa u tha më sipër rezultojnë së terrorizmi në Kosovë mund të ketë pasoja në shumë fusha, dhe ato mund të jenë pasoja të brendshme dhe të jashtme, ekonomike, politike, sociale, shëndetësore dhe etnike.

Pasojat e brendshme kanë të bëjnë më sigurinë e jetës dhe pasurisë së qytetarëve të Kosovës, më sigurinë e ushqimit, ujit dhe ajrit, që lidhen më shëndetin e qytetarëve, si dhe më gjendjen sociale të një pjesë të popullatës, e

⁸⁶ Po aty, f.116-117

⁸⁷ Demolli, Haki, 2002, Terrorizmi, Fakulteti Juridik Prishtinë, f.130-132

gjithashtu edhe në përkeqësimin e raporteve ndëretnike të shumicës më disa nga pakicat në Kosovë, ndërsa sa i përket pasojave të jashtme, terrorizmi mund të ketë efekte mjaft negative në imazhin e Kosovës në botë, në rrugëtimin Kosovës për liberalizim dhe lëvizje të lirë të qytetarëve, në integrimin e Kosovës në Bashkimin Europian dhe në organizatat euroatlantike.

Ky përkeqësim i imazhit mund të ketë pastaj pasojat e veta në zhvillimin ekonomik të Kosovës, në krijimin e problemeve politike në raportet ndërkombëtare por edhe vetë brenda sistemit politik të Kosovës.

Duke marr parasysh këto pasoja, Institucionet e Kosovës që merren më zbatimin e ligjit, kanë arritur që të ndërmarrin veprime proaktive për zbulimin, hetimin, akuzimin dhe dënimin e personave të përfshirë në përgatitjen apo edhe pjesëmarrjen në kryerjen e akteve terroriste, në vendet arabe – Siri dhe Irak.

Sipas të dhënave të prezantuara nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës⁸⁸, rezultojnë së deri më tani numri i personave të trajtuar si të dyshuar për terrorizëm është 147 persona, numri i personave të vrarë në zonat e konfliktit është 60 persona nga të cilët 3 kanë kryer akte vetëvrasëse, numri i grave të cilat konsiderohet se janë në zonat e konfliktit është 37, numri i fëmijëve 54, nga të cilët 22 kanë lindur në këto zona të konfliktit. Aktualisht në këto zona llogaritet se janë 94 persona.

Sa i përket ndjekjes penale të këtyre rasteve dhe ndëshkimit të personave të dyshuar, të dhënat statistikore tregojnë se Kosova ka arritur një sukses të mirë, sepse vetëm gjatë vitit 2016 janë pranuar 37 kallëzime penale me 103 persona ndërsa janë zgjidhur 28 kallëzime penale me 66 persona, ndërsa gjatë periudhës janar – mars 2017, është pranuar vetëm 1 rast me 3 persona dhe janë zgjidhur 6 kallëzime penale me 8 persona⁸⁹.

5. MISIONI DHE OBJEKTIVAT E KOSOVËS PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TERRORIZMIT

Duke marr për bazë situatën e krijuar pas paraqitjeve të rasteve të dyshuara për terrorizëm në Kosovë (arrestimin e të dyshuarve për terrorizëm) Kosova ka nxjerr Strategjinë kombëtare kundër terrorizmit⁹⁰ si dhe planin e veprimit për zbatimin e kësaj strategjie, ku ndër të tjera ka parashikuar edhe synimet dhe objektivat e saj duke parashikuar që të bëhet:

Krijimi i një ambienti të sigurt për qytetarët e Republikës së Kosovës, krijimi i kapaciteteve efikase dhe efektive për t'u ballafaquar me terrorizmin, zhvillimi dhe fuqizimi i partneritetit në nivel të vendit, regionit dhe në atë ndërkombëtar në fushën e kundër-terrorizmit, identifikimi dhe minimizimi i faktorëve dhe shkaqeve të cilët mund të qojnë në krijimin e ambientit të favorshëm për paraqitjen dhe përhapjen e ideve të ekstremizmit të dhunshëm, identifikimi me kohë i faktorëve dhe shkaqeve që mund të nxisin qytetarët në ekstremizëm dhe radikalizëm të dhunshëm, promovimi i vlerave demokratike, barazisë si dhe tolerancës ndëretnike dhe ndërfetare, identifikimi, monitorimi dhe përcjellja e formave të ndryshme të influencës globale që ndikojnë në radikalizëm të individëve apo grupeve të caktuara, reagimi dhe kundërvënia ndaj ideologjisë e cila propagandon apo përkrah dhunën, pengimi i ushtrimit të ndikimit si dhe ballafaqimi me kërcënimin që vjen nga ata që e promovojnë atë, fuqizimi i bashkëpunimit dhe koordinimi ndërinstitucional, rajonal, ndërkombëtar si dhe organizatave ndërkombëtare, ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të Institucioneve të Republikës së Kosovës në identifikim dhe parandalim.

Lidhur më parandalimin është parashikuar edhe parandalimi, pengimi dhe hetimi i ekstremistëve të dhunshëm apo terroristëve që të influencojnë, rekrutojnë, planifikojnë dhe ndërtojnë legjitimitet brenda territorit të Republikës së Kosovës, ngritja e partneritetit me komunitetin, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional, rajonal, ndërkombëtar si dhe organizatave ndërkombëtare, ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të Institucioneve të Republikës së Kosovës në identifikim, parandalim, zbulim dhe ndjekje.

Kur është në pyetje zbulimi dhe ndjekja është parashikuar mbrojtja e qytetarëve të Republikës së Kosovës, pronës së tyre si dhe mbrojtjen e infrastrukturës kritike nga të gjitha aktet terroriste, parandalimi i përvetësimit dhe përdorimit të mallrave strategjike, mallrave me përdorim të dyfishtë, armët e shkatërrimit në masë, ngritja e masave të sigurisë në kufijtë e Republikës së Kosovës, kontrolli dhe mbikëqyrja e lëvizjes së qytetarëve dhe mallrave përgjatë kufirit, ndërmarrja e masave për mbrojtje nga ndërhyrjet dhe sulmet kibernetike, hartimi i planeve për mbrojtje dhe skenarëve për reagim të infrastrukturës kritike dhe objekteve të rëndësishme të veçantë, ngritja e gatishmërisë për rreziqet me efekt më të lartë goditës në Vlerësimin Kombëtar të Rreziqeve, vazhdimi i ngritjes së kapaciteteve

⁸⁸ Blakaj, Elez, 2017, Prezantimi i kumtesës më titull Parandalimi dhe luftimi i financimit të terrorizmit dhe pastrimit të parave, në punëtorinë "Financimi i terrorizmit dhe pastrimi i parave" të organizuar nga Ambasada Amerikane (ICITAP dhe OBDAT) më datë 28.06.2017

⁸⁹ Lumezi, Aleksandër, prezantim i fjalës hyrëse në punëtorinë "Financimi i terrorizmit dhe pastrimi i parave" të organizuar nga Ambasada Amerikane (ICITAP dhe OBDAT) më datë 28.06.2017

⁹⁰ Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit 2012 – 2017, qershor 2012, f.12-14

gjeneruese për të reaguar dhe rimëkëmbur nga gama e gjerë e emergjencave terroriste dhe emergjencave tjera civile, menaxhimi dhe eliminimi i pasojave të shkaktuara nga sulmet e mundshme terroriste, ngritja e partneritetit me komunitetin, si dhe bashkëpunimi dhe koordinimi ndërinstitucional, rajonal, ndërkombëtar si dhe organizatave ndërkombëtare, si dhe ngritja dhe fuqizimi i kapaciteteve të Institucioneve të Republikës së Kosovës për menaxhim dhe reagim.

Në fund mund të thuhet së përgjegjësia për parandalimin, luftën dhe menaxhimin e pasojave të akteve terroriste dhe përgjegjësia për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut bie kryesisht mbi shtetin. Megjithatë, shteti duhet të kërkojë mbështetjen e shoqërisë civile, medias, sektorit privat dhe komunitetit të biznesit për të realizuar me sukses luftën kundër terrorizmit. Lufta kundër terrorizmit është rrjedhimisht një përgjegjësi e përbashkët dhe kërkon përfshirjen dhe bashkëveprimin e përbashkët të policisë, autoriteteve të tjera publike dhe popullatës⁹¹.

6. PËRFUNDIM

Duke marr parasysh rëndësinë që ka parandalimi dhe luftimi i terrorizmit për hapjen e proceseve për anëtarësim në Bashkimin Europian dhe në strukturat tjera euro-atlantike, ky punim përmban një analizë të terrorizmit, si rrezik për sigurinë e brendshme dhe të jashtme të Kosovës.

Analiza e këtij fenomeni mund të ndihmojë në kuptimin më të mirë të elementeve të terrorizmit, si dhe shkaqet e kryerjes së tij dhe kjo mundëson një lehtësim në punën e autoriteteve kompetente për të hetuar, ndjekur dhe luftuar këto veprime kundër ligjore.

Në ditët e sotme, kur kriza ekonomike dhe politike në Kosovë është gjithnjë e më e theksuar, grupet kriminale gjithnjë e më shumë po shfrytëzojnë situatën për të gjetur njerëz në nevojë që kanë synim një jetë më të mirë, për ti dërguar në luftërat e huaja.

Sa i përket sigurisë së brendshme dhe sigurisë së jashtme, terrorizmi paraqet rrezikun më të madh për Kosovën. Ky fenomen mund të ketë pasoja të brendshme, të jashtme, ekonomike, politike, sociale, shëndetësore dhe etnike, sepse lidhen me sigurinë fizike dhe ekonomike të qytetarëve të Kosovës, si dhe më rrezikun për të humbur përkrahjen e vendeve mike dhe për të ngadalësuar apo pamundësuar anëtarësimin e Kosovës në strukturat euroatlantike.

LITERATURA

Demolli, H. (2002). Terrorizmi, Fakulteti Juridik, Prishtinë

Handbuch politisch (1985). sozialer Grundbegriffe in Frankreich 1680 - 1820, München

Hide, E. (n.d.). Terrorizmi dhe reagimi shtetror pas luftës së ftohtë, Tiranë, marr nga

<http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2014/02/Doktoratura-Enri-Hide-Fakulteti-i-Histori-Filologjiise-Departamenti-i-Historise.pdf>, qasja mw datw 26.06.2017

Hysi, V. (2010). Kriminologjia, botim i dytë, Universiteti i Tiranës – Fakultetit i Drejtësisë, Tiranë

Krasniqi, K. (2010). Terrorizmi Ndërkombëtar

Klarin, M. (1979). “Terrorizmi” Beograd

Latifi, V. (2017). Mediat dhe terrorizmi, marr nga http://www.kolegji-juridica.org/new_web/wp-content/uploads/2017/03/Dr.-Vesel-LATIFI-Mediat-dhe-terrorizmi.pdf, qasja më datë 26.06.2017

Meqalla, Eraldo, marr nga <http://www.tiranaobserver.al/nje-veshtrim-rreth-terrorizmit-nderkombetar/>

OSCE, (2014). Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet

Strategjia kombëtare e Republikës së Kosovës kundër terrorizmit 2012 – 2017

(2004). Kodi Penal i Kosovës

(2012). Kodi Penal i Republikës së Kosovës

(1999). Konventën e Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të Terrorizmit

(1937). Konveta e Gjenevës mbi pengimin dhe ndëshkimin e terrorizmit

⁹¹ OSCE, Parandalimi i terrorizmit dhe lufta kundër ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm që favorizojnë terrorizmin: qasja e policimit në komunitet, mars 2014